



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Data ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemim Asfaltim Bulevardi Nënë Tereza Loti 2 & Rruga Teuta”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6

- *Punime ndërtimi për rrugë*

VLERA E FONDIT LIMIT: 60,027,500 (gjashtëdhjetë milion e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.*

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Shënim: *Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **30,013,750** (tridhjetë milion e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **120,055,000** (njëqind e njëzet milion e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore për te vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes;
- b) Situacionin përfundimtar të objektit;
- c) Aktin e Kolaudimit të objektit;
- d) Formular Vlerësimi (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- e) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- Nëse kontrata është realizuar me subjekte private për te vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit të objektit

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratë bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

***Argumentimi:** Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.*

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të vlefshme të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-4 C** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **N.P-12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-6 A** Sinjalistika rrugore jo ndricuese
- **NS-18 A** Punime Topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr. 42, datë 16.01.2008 (i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me rehabilitimin ne

rrugë ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore si kriter në procedurat e prokurimit për ndërtimin e rrugëve është e domosdoshme për të garantuar menaxhimin e ndikimeve mjedisore që shkaktohen gjatë zbatimit të projektit. Ndërtimi i rrugëve ndikon në tokë, ujëra dhe mjedisin përreth, ndaj kërkohet që operatorët të kenë kapacitete për kontrollin e erozionit, menaxhimin e mbetjeve.

N.S-6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me sinjalistika rrugore jondriçuese si sinjalistike vertikale dhe horizontale, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-18 A Punime topogjeodezike: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen Punime topogjeodezike, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Kërkesa për licencë NS-18 A lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, të cilat kërkojnë piketim, nivelim dhe kontroll të saktë gjeometrik gjatë zbatimit të projektit rrugor. Kjo licencë garanton kapacitetet teknike për realizimin korrekt të punimeve dhe përputhshmërinë me projektin.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të percaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë;
- c) Libreze pune.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedeklarimit. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të percaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi

Vendimin nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit” ku përcaktohet se: “1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, KREU IV pika 2, germa b) ku përcaktohet: Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si drejtues teknik dhe ndalohet të disponojë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit; dhe KREU III, pika 3, germa “c” ku përcaktohet se: “Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dypozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinjer Gjeodet/Topograf/Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

1 Inxhinier Ndërtimi: *Referuar preventivi të punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar N.P-4, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**. Kërkohe për drejtimin teknik të punimeve civile të infrastrukturës rrugore, përfshirë shtresat rrugore, trotualet dhe elementët përbërës, duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve.*

1 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder: *Referuar preventivi të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës N.P-4, N.S-6, NS 18. Kërkesa për 1 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder është e domosdoshme pasi ai siguron zbatimin e saktë të projektit në terren, duke përcaktuar koordinatat, kuotat, piketimet dhe gjurmën e rrugës. Ai kontrollon nivelimet dhe parametrat teknikë gjatë gjithë fazave të punimeve, si dhe realizon matjet për volume dhe situacione. Prania e tij garanton cilësi, shmang devijimet nga projekti dhe është thelbësore për realizimin korrekt dhe sipas standardeve të punimeve rrugore.*

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf mbështetës jo domosdoshmerisht të përfshirë në licencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Infrastruktura Transport**

Shënim: *Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

Argumentim: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Inxhinier Ndërtimi Profili Infrastruktura Transport: Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP-1, NP-4, NS-1 është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit të Ndërtimit Profili Infrastruktura Transporti. Ky profesionist ka kompetencat e nevojshme për projektimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve infrastrukturore rrugore, duke siguruar që të gjitha fazat e ndërtimit të përputhen me standardet teknike dhe specifikimet e projektit. Ai luan rol kyç në organizimin e punimeve, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe zbatimin korrekt të teknologjive të ndërtimit. Gjithashtu, inxhinieri i infrastrukturës së transportit kontribuon në garantimin e sigurisë rrugore dhe qëndrueshmërisë së veprës, duke minimizuar defektet dhe ndërhyrjet e mëvonshme. Prania e tij siguron një menaxhim më efikas të projektit dhe shmang rreziqet që lidhen me zbatimin jo korrekt të punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

a) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jenë të pajisur me çertifikatën e Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, e lëshuar nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e **3 (tre) muajt e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar sipas të cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në

këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **24 (njëzet e katër) punonjës** punonjës për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës përkatëse në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.*

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

*Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **24 (njëzet e katër)** punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 140 ditë kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në Vendimin nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.*

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

*Kërkesa për **24 (njëzet e katër)** punonjës është e justifikuar nga volumi dhe kompleksiteti i punimeve në një projekt ndërtimi. Ky numër siguron fuqinë e nevojshme punëtoresh për zhvillimin*

paralel të proceseve të ndryshme, duke garantuar respektimin e afateve, cilësinë e zbatimit dhe funksionimin efikas të kantierit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi Diplomë të shkollës mesme
- 1 (një) Teknik Topograf Diplomë të shkollës mesme
- 6 (gjashtë) Punëtorë Asfalti Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 4 (katër) Punëtorë të thjeshtë

Krahas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

nr.	emër mbiemër i punonjësit	profesioni	institucioni public/privat lëshues i certifikatës/diplomës	nr. i certifikatës/diplomës	nr nipt (në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.					
2.					
etj.					

Shënim: Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në dst, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmi/çertifikatë kualifikimi ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ose të lartë.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme). Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve:

- **Teknik Ndërtimi:** Kërkohe për mbikëqyrjen e punimeve ditore në terren, organizimin e ekipeve të punës dhe zbatimin korrekt të udhëzimeve të inxhinierëve, duke garantuar cilësinë dhe rendin në punime.
- **Teknik Topograf:** Tekniku topograf është i domosdoshëm në ndërtimin e një rruge sepse siguron trase të saktë, nivelime korrekte dhe përputhje me projektin. Ai kontrollon gjerësinë, pjerrësinë dhe kuotat e rrugës, duke shmangur gabime që mund të sjellin kosto shtesë dhe probleme në kullim apo siguri.
- **Punëtorë Asfalti:** Për shtrimin, nivelimin dhe përfundimin e shtresave asfaltore, duke siguruar cilësinë, nivelin dhe funksionalitetin e rrugës.
- **Punëtorë të thjeshtë:** Për ndihmë në transport materialesh, mbajtje rendi në punime, dhe aktivitetet ndihmëse të nevojshme për realizimin e kontratës, duke mbështetur ekipet teknike dhe specialistët.

Prezenca e këtyre punonjësve në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- 2 (dy) Eskavatoristë
- 2 (dy) Automakinistë
- 1 (një) Buldozeristë
- 3 (tre) Shoferë të makinerive të rënda

Ofertuesi për stafin e mësipërm duhet të paraqesë:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- d) Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Në rastin kur punonjësit Automakinist, Ekskavatoristë, Shofer ose Buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.*

Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Numri dhe kualifikimi i punonjësve të paraqitur në këtë ofertë është përcaktuar në përputhje me mjetet dhe makineritë e deklaruar për realizimin e kontratës. Çdo mjet i parashikuar shoqërohet me personelin përkatës teknik të nevojshëm për operimin e tij, duke garantuar funksionim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Konkretisht, numri i shoferëve, buldozeristëve, eskavatoristë dhe automakinistëve është dimensionuar mbi bazën e numrit dhe llojit të makinerive të angazhuara, për të përballuar ngarkesën e punës dhe çdo situatë operative.

Kjo qasje garanton një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore në raport me kapacitetet teknike, duke rritur sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në tërësi, këto kërkesa për staf minimal janë të justifikuara nga: Volumi dhe dinamika e punimeve; Nevoja për paralelizëm në procese; Respektimi i afateve kontraktuale; Garantimi i sigurisë në kantier; Cilësia e zbatimit sipas standardeve të ndërtimit të rrugëve.

Prandaj, vendosja e këtyre kriterëve në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të projektit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 1.2-3.5 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti	2 copë	Në pronësi ose me qera
7	Rrul për bankina	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Fadrome me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
9	Eskavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Eskavator me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Minifadromë	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Dumper kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Grejder me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Asfaltoshtruese	2 copë	Në pronësi ose me qera
15	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Makineri (spërkatës) për vijezim rruge me bojë bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qera
18	Tokmak për ngjeshje (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qera
19	Gjenerator ≥ 3.5 kw	1 copë	Në pronësi ose me qera
20	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera

21	Makineri për skarifikim shtresash asfalti ekzistues	1 copë	Në pronësi ose me qera
----	---	--------	------------------------

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.

b) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin miet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Për autobitumatriçe të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshme.

f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklarara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

g) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim". Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të

realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Argumentim Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim .”

Konkretisht:

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave të largëta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave ndërmjetëse më të afërta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave brenda dhe jashtë kantierit në rast nevojë që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.

- **Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 1.2-3.5 Ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit të materialeve të këtij tonazhi kryesisht brenda dhe jashtë kantierit për furnizime.

- **Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash** i referohet analizave të preventivit për ngjeshjen e shtresave rrugore çakëll, granil.

- **Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti** i referohet analizave të preventivit për ngjeshjen e shtresave rrugore asfaltike.

- **Rrul për bankina ngjeshje shtresash dhe asfalti** në pjesën e bankinave.

- **Fadroma me targa** përdoret për ngarkimin, lëvizjen dhe shpërndarjen e materialeve inerte, si dhe për përgatitjen e bazës së rrugës. Nevoja e një mjeti me targa lind si pasoje e lëvizjes nga sektor në një tjetër në rrugët publike pa i dëmtuar ato.

- **Eskavator me zinxhiri** referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit dhe prishjeve.

- **Eskavator me targa** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit, nevoja e një mjeti me targa lind si pasoje e punimeve në shtresa betoni ose asfaltike pa i dëmtuar ato. Nevoja e një mjeti me targa lind si pasoje e lëvizjes nga sektor në një tjetër në rrugët publike pa i dëmtuar ato.

- **Minifadromë**, i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit dhe të spostimit të materialeve brenda zonave të ngushta të kantierit.

- **Dumper kantieri** : është një mjet i vogël vetëshkarkues, shërben për transportin e materialeve të ndërtimit brenda kantierit ose në terrene të vështira ku nuk mund të lëvizin kamionë të mëdhenj.

- **Grejder me targa** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen shtresat rrugore. Nevoja e një mjeti me targa lind si pasoje e lëvizjes nga sektor në një tjetër në rrugët publike pa i dëmtuar ato.

- **Asfaltoshtues dhe Autobitumatrice** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e asfaltimit

- **Autobot uji** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen shtresat rrugore, ku lagia me ujë është domosdoshme për trajtimin e tyre gjithashtu dhe për uljen e pluhurave në zona të banuara.
- **Makineri (spërkatës) për vijezim rruge me bojë bikomponente:** është në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe standardet përkatëse për sinjalistikën horizontale rrugore. Kjo pajisje mundëson aplikimin e bojës bikomponente me saktësi të lartë, duke garantuar trashësi uniforme të shtresës..
- **Gjenerator $\geq 3.5\text{kW}$:** nevojitet për raste emergjencash për pajisjet që punojnë me energji elektrike.
- **GPS** një kërkesë thelbësore për saktësi, koordinim dhe kontroll të punimeve në terren.
- **Makineri për skarifikim shtresash asfalti ekzistues:** përfshihet si mjet i domosdoshëm për heqjen e kontrolluar të shtresave ekzistuese të asfaltit dhe përgatitjen e sipërfaqes për shtresat e reja. Ajo siguron frezim uniform, respektim të kuotave dhe lidhje të qëndrueshme ndërmjet shtresave, duke garantuar cilësi të lartë dhe jetëgjatësi të punimeve rrugore.

Këto makineri janë të justifikuara sepse: mbulojnë të gjitha fazat e ndërtimit të rrugës; mundësojnë punë të njëkohshme në disa fronte; garantojnë cilësi sipas standardeve teknike; ndihmojnë në përmbushjen e afateve kontraktuale dhe rrisin efikasitetin në kantier.

2.3.11 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- * **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)**
- * **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**
- * **ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë)**

Shënim: Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomik, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti

kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Në ndërtimin e rrugëve, ku cilësia e shtresave (bazë, nënbazë, asfalt) është kritike për jetëgjatësinë e investimit, ISO 9001 minimizon rrezikun e defekteve dhe punimeve jashtë standardit.

ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet **mjedisore** ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Në një zonë si Valiasi (zonë e banuar), kjo është veçanërisht e rëndësishme për të minimizuar ndikimin negativ tek komuniteti dhe mjedisi përreth.

ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë) është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 /45001-2023, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Punimet e ndërtimit të rrugëve përfshijnë rreziqe të larta (makineri të rënda, trafik, punë në terren). Kjo certifikatë siguron që: të identifikohen dhe menaxhohen rreziqet në kantier, mbrohen punonjësit dhe palët e treta, reduktohen aksidentet dhe incidentet në punë.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.*

Ne Ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 68, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i licensuar me Kodin III.2.B është e nevojshme sepse gjatë ndërtimit të rrugës krijohen mbetje ndërtimore që duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Grafikon e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”, si dhe Neni 39, pika 3 e kesaj VKM-je.*

Argumentim: *Kërkesa është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin*

Publik”, të ndryshuar; Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kjo lidhet direkt me procedurën e ndërtimit, pasi materialet përdoren në sistemet e kullimit dhe infrastrukturën e shërbimit rrugor. Përdorimi i materialeve të certifikuara garanton që tubacionet për ujërat e shiut ose kanalizimet teknike të jenë të qëndrueshme dhe funksionale, duke parandaluar rrjedhjet, dëmtimet ose bllokimet që mund të pengojnë procesin e punimeve ose të shkaktojnë riparime të shpeshta. Bordurat janë elementë kritikë në përcaktimin e kufijve të karrexhatës, stabilizimin e shtresave anësore dhe drejtimin e ujërave sipërfaqësore. Pllakat e trotuarit përbëjnë një komponent thelbësor në ndërtimin e hapësirave për këmbësorë, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë, qëndrueshmërinë dhe estetikën e infrastrukturës urbane. Kështu, verifikimi i certifikatave, autorizimeve dhe katalogëve është një hap i integruar në procedurën e kontrollit të cilësisë dhe siguron që çdo komponent i përdorur të plotësojë standardet teknike të projektit dhe kërkesat ligjore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në DST përcaktohet se:

Ndalohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera për pikat:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin të punëve të ngjashme

2.3.2 Disponimi i licensës profesionale

2.3.4 Stafi kryesor i kualifikuar (drejtuesit Teknik)

Argumentimi: *Kjo procedure karakterizohet nga një vlerë e lartë investimi dhe një rëndësi e veçantë për interesin publik, vlerësohet thelbësore që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të verifikueshme kriteret kryesore të kualifikimit, konkretisht përvojën në punë të ngjashme, stafin drejtues teknik dhe licencën profesionale.*

Në rastet kur operatori ekonomik nuk i zotëron vetë këto kapacitete dhe mbështetet në subjekte të tjera, krijohet një ekspozim i konsiderueshëm ndaj riskut të mosrealizimit të kontratës. Kjo për

faktin se elementet e sipërpërmendura nuk janë thjesht kritere formale, por përbëjnë bazën funksionale dhe operacionale për zbatimin me sukses të investimit.

Mungesa e përvojës së drejtpërdrejtë në punë të ngjashme rrit ndjeshëm probabilitetin e gabimeve në planifikim, në menaxhimin e proceseve dhe në përballimin e situatave të paparashikuara gjatë zbatimit. Në projekte me vlerë të lartë (siç është procedura objekt prokurimi), këto mangësi mund të përkthehen në vonesa të konsiderueshme, rritje të kostove dhe ulje të cilësisë së punimeve apo shërbimeve.

Njëkohësisht, mosdisponimi real i stafit drejtues teknik krijon pasiguri mbi aftësinë e operatorit për të menaxhuar kontratën në mënyrë efektive. Nëse ky staf nuk është pjesë organike e operatorit, ekziston rreziku që ai të mos jetë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme ose të tërhiqet gjatë zbatimit, duke sjellë ndërprerje, çorganizim dhe dobësim të kontrollit teknik të projektit.

Po ashtu, mungesa e licencës profesionale në mënyrë të drejtpërdrejtë nga operatori përbën një risk të qartë ligjor dhe operacional. Kjo situatë mund të çojë në pengesa administrative, pezullim të punimeve apo edhe pavlefshmëri të veprimeve të kryera, me pasoja të drejtpërdrejta në ecurinë e investimit.

Duke pasur parasysh vlerën e lartë të kontratës, çdo dështim apo mosrealizim i saj nuk sjell vetëm pasoja për autoritetin kontraktor, por edhe dëm ekonomik dhe social më të gjerë, përfshirë bllokimin e fondeve publike, mosrealizimin e objektivave të projektit.

Në këtë këndvështrim, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera për këto kritere thelbësore rrit ndjeshëm riskun e transferimit formal të kapaciteteve pa garanci reale për disponueshmërinë dhe përdorimin e tyre efektiv gjatë zbatimit të kontratës.

Për rrjedhojë, për një procedurë me këtë nivel investimi dhe rëndësie, vlerësohet e domosdoshme që operatorët ekonomikë të provojnë kapacitetet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejtë, duke minimizuar rreziqet e mosrealizimit dhe duke garantuar një përdorim efikas dhe të sigurt të fondeve publike.

I. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukturore dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara në rikonstrukcionin e rrugëve në njësitë administrative. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme

në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurta qarkullimi për banorët e zonës.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

NJËSIA E PROKURIMIT